Letra me vlerë të borxhit	...	12.6	-12.6
Kreditë
Kreditë tregtare dhe paradhëniet
Instrumente tjera të borxhit
Afatgjatë	158.6	671.9	-513.3
Alokimet e të drejtës së tirazhit (DST-të)	158.6	166.7	-8.1
Valuta dhe depozita	0.0	0.0	0.0
Letra me vlerë të borxhit	0.0	505.2	--505.2
Kreditë
Kreditë tregtare dhe paradhëniet
Instrumente tjera të borxhit
Korporata depozituese, me përjashtim të Bankës Qendrore	718.8	1,226.9	-508.1
Afatshkurtër	601.2	808.1	-207.0
Valuta dhe depozita	488.3	545.8	-57.4
Letra me vlerë të borxhit	0.0	206.9	--206.9
Kreditë	107.2	52.5	54.7
Kreditë tregtare dhe paradhëniet	0.0	0.0	0.0
Instrumente tjera të borxhit	5.6	3.0	2.6
Afatgjatë	117.6	418.8	-301.1
Sektorë tjerë	1,760.5	1,534.1	226.4
Afatshkurtër	991.6	1,404.6	-413.0
Valuta dhe depozita	0.0	1,338.1	-1,338.1
Letra me vlerë të borxhit	0.0	0.0	0.0
Kreditë	453.4	40.3	413.2
Kreditë tregtare dhe paradhëniet	538.2	25.3	512.9
Instrumente tjera të borxhit	0.0	0.9	-0.9
Afatgjatë:	768.9	129.5	639.4
Valuta dhe depozita	0.0	0.0	0.0
Letra me vlerë të borxhit	0.0	0.5	-0.5
Kreditë	768.9	129.0	639.9
Investimet Direkte: Kreditimi ndërmjet kompanive	930.2	69.1	861.1
Borxhi i ndërmarrjeve të investimit direkt ndaj investitorëve direktë	8.2	16.1	-7.9
Borxhi i investitorëve direktë ndaj ndërmarrjeve të investimit direktë	875.9	43.4	832.6
Borxhi ndërmjet ndërmarrjeve të lidhura	46.2	9.7	36.5
Borxhi i Jashtëm NETO (3)	4,426.0	4,428.6	-2.6

Tabela 34.1. Asetet në formë të investimeve portfolio sipas shteteve

(Në milionë euro: Gjendja në fund të periudhës - Qershor 2025)

Përshkrimi	Vendi	Ekuitet	Gjithsej letrat me vlerë të borxhit		Gjithsej	
			Letrat me vlerë të borxhit afatgjatë	Letrat me vlerë të borxhit afatshkurtë		
AE	Emiratet Arabe	-	0.1	-	0.1	
AL	Shqipëria	-	15.1	-	15.1	
AT	Austria	-	118.2	77.4	118.2	
BE	Belgjika	-	127.9	48.2	127.9	
BR	Brazili	-	-	-	-	
CH	Zvicra	-	-	-	-	
CI	Bregu i Fildishtë	-	1.7	1.7	1.7	
DE	Gjermania	0.2	108.0	51.7	108.2	
DK	Danimarka	-	-	-	-	
EG	Egjipti	-	4.5	4.5	4.5	
FR	Franca	252.2	66.6	31.8	318.8	
GB	Britani e Madhe	22.6	-	-	22.6	
GR	Greqia	-	5.4	5.4	5.4	
JP	Japonia	-	-	-	-	
IE	Irlanda	1,226.8	4.6	4.6	1,231.4	
LU	Luksemburgu	780.0	3.9	3.9	783.9	
ME	Mali i Zi	-	5.7	5.7	5.7	
MX	Meksika	-	-	-	-	
NG	Nigeria	-	2.7	2.7	2.7	
NL	Holanda	-	43.5	43.5	43.5	
PL	Polonia	-	2.0	2.0	2.0	
RO	Romania	-	4.9	4.9	4.9	
SE	Suedia	-	-	-	-	
SI	Slovenia	-	4.1	4.1	4.1	
SK	Slovakia	-	-	-	-	
SN	Senegali	-	2.9	2.9	2.9	
TG	Togo	-	-	-	-	
TN	Tunisia	-	-	-	-	
TR	Turqia	-	7.9	7.9	7.9	
US	Shtetet e Bashkuara	432.2	116.6	82.7	548.8	
UA	Ukrahina	-	-	-	-	
UZ	Uzbekistani	-	8.9	8.9	8.9	
ZA	Afrika e Jugut	-	10.2	10.2	10.2	
ZZ	Te tjera	-	75.4	75.4	75.4	
Gjithsej vlera e investimeve portfolio		2,714.0	693.5	485.0	208.5	3,407.5

Tabela 35.1 Tregtia në mallra - eksportet sipas partnerëve tregtar

(Në milionë euro)

Përshkrimi	Gjithsej					
	Evropa	Vendet jo Evropiane			Vende tjera Evropiane	
		Bashkimi Evropian	CEFTA			
2004	56.6	55.5	16.6	23.5	15.4	1
2005	56.3	54.2	21.8	29.9	2.6	2
2006	110.8	109.4	42.3	51.7	15.4	1.3
2007	165.1	156.8	69.3	65.1	22.4	8.3
2008	198.5	171.1	94	61.5	15.6	27.3
2009	165.3	144.2	71.3	53.5	19.5	21.1
2010	296.0	228.6	134.6	66.9	27.2	67.3
2011	313.2	245.3	139.4	80.3	25.5	73.8
2012	276.1	236.6	107.4	102.6	26.5	39.5
2013	293.8	237.6	115.8	107.1	14.7	56.2
2014	324.5	245.8	95.7	129.5	20.5	78.8
2015	325.3	250.8	106.1	123.7	21.0	74.5
2016	309.6	239.0	70.0	144.3	24.7	70.6
2017	378.0	306.2	94.2	182.7	29.3	71.8
2018	367.5	322.0	110.9	173.5	37.6	45.5
2019	383.5	340.8	138.5	164.8	37.4	42.7
2020	475.0	439.4	178.3	210.7	50.4	35.5
2021	756.0	598.6	236.8	278.4	83.3	157.4
2022	997.8	835.6	322.4	400.3	112.8	162.2
2023	874.5	743.5	278.7	354.9	109.9	131.0
2024	943.6	865.3	312.6	428.1	124.6	78.3
2024 Prill	73.2	68.0	25.0	32.6	10.4	5.2
Maj	85.7	80.3	28.3	39.7	12.3	5.3
Qershor	73.4	68.0	24.9	32.9	10.2	5.4
Korrik	86.1	80.1	26.4	45.1	8.6	6.0
Gusht	83.6	77.9	24.0	43.7	10.1	5.7
Shtator	77.5	71.7	27.3	33.5	10.9	5.9
Tetor	87.3	81.1	28.2	39.9	13.0	6.2
Nëntor	96.1	91.6	33.6	44.7	13.3	4.4
Dhjetor	69.6	65.3	23.7	33.2	8.4	4.3
2025 Janar	59.7	56.7	22.5	24.1	10.0	3.0
Shkurt	67.3	64.2	24.5	28.9	10.7	3.1
Mars	74.7	70.9	26.0	33.5	11.5	3.9
Prill	73.9	70.2	25.3	33.9	11.0	3.6
Maj	81.4	77.4	29.0	34.5	13.9	4.0
Qershor	80.4	77.6	27.6	36.9	13.1	2.8
Korrik	83.8	79.1	28.8	39.5	10.8	4.8
Gusht	76.2	73.5	23.4	38.2	11.9	2.7

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe llogaritjet e BQK-së.

Tabela 35.2 Tregtia në mallra - importet sipas partnerëve tregtar
(Në milionë euro)

Përshkrimi	Gjithsej					
		Evropa				Vendet jo Evropiane
		Bashkimi Evropian	CEFTA	Vende tjera Evropiane		
2004	1,063.3	947.1	424.7	368.7	153.6	116.2
2005	1,157.5	1,017.5	439.7	440.4	137.5	139.9
2006	1,305.9	1,153.6	454.3	536.3	163.0	152.3
2007	1,576.2	1,350.4	572.9	579.6	197.9	225.8
2008	1,928.2	1,654.8	702.0	717.8	235.0	273.4
2009	1,935.5	1,659.2	755.0	692.5	211.7	276.3
2010	2,144.9	1,839.8	821.3	799.0	219.5	305.1
2011	2,479.3	2,092.7	941.7	899.5	251.4	386.6
2012	2,507.6	2,067.7	978.1	844.7	244.9	439.9
2013	2,449.1	2,011.2	1,009.8	749.7	251.7	437.8
2014	2,538.3	2,090.2	1,018.1	783.3	288.8	448.1
2015	2,634.7	2,179.2	1,112.9	769.4	296.9	455.5
2016	2,789.5	2,287.0	1,202.2	753.2	331.6	502.5
2017	3,047.2	2,520.0	1,311.9	856.1	352.0	527.3
2018	3,347.0	2,733.1	1,457.3	853.6	422.2	613.9
2019	3,497.1	2,779.8	1,749.3	502.6	527.8	717.3
2020	3,296.9	2,656.2	1,539.1	615.3	501.8	640.7
2021	4684.2	3715.6	2076.0	892.9	746.7	968.7
2022	5639.3	4348.7	2388.8	1000.6	960.9	1289.0
2023	5912.8	4455.4	2542.0	926.4	987.0	1457.4
2024	6371.1	4727.0	2850.5	851.8	1024.7	1644.1
2024 Prill	503.9	386.2	244.7	65.6	75.9	117.8
Maj	516.3	383.1	234.6	67.4	81.1	133.2
Qershor	510.0	367.2	232.5	64.6	70.1	142.8
Korrik	593.2	432.2	276.1	66.8	89.2	161.1
Gusht	588.2	420.2	246.6	74.8	98.9	167.9
Shtator	509.5	365.8	213.4	65.3	87.1	143.7
Tetor	580.3	424.1	255.5	74.5	94.2	156.2
Nëntor	566.9	401.4	242.5	72.1	86.9	165.5
Dhjetor	631.2	465.0	269.8	99.6	95.6	166.1
2025 Janar	473.9	357.3	204.5	83.6	69.3	116.5
Shkurt	518.7	392.6	229.1	83.4	80.1	126.1
Mars	610.6	448.5	249.1	101.5	98.1	162.0
Prill	566.2	401.7	237.6	74.3	89.8	164.5
Maj	604.7	434.1	265.1	69.6	99.4	170.6
Qershor	578.7	414.1	249.6	82.7	81.8	164.6
Korrik	660.2	457.1	283.1	79.6	94.4	203.1
Gusht	613.0	431.7	261.7	77.9	92.1	181.4

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe llogaritjet e BQK-së.

Tabela 35.3 Tregtia në mallra - eksportet sipas grupit të mallrave

(Në milionë euro)

Përshkrimi	Gjithsej, prej të cilave															
	II. Produkte perimesh	IV. Artikuj ushqimor të përgaditur, pijë dhe duhan	V. Produktet minerale	VI. Produktet e industrisë kimike ose të industrive të ngjashme	VII. Plastika, goma dhe artikuj prej tyre	VIII. Gëzof, lëkurë dhe artikuj prej tyre	IX. Druri dhe artikuj prej tij	X. Material celulozë, letër dhe artikuj prej tyre	XI. Tekstilët dhe artikuj prej tyre	XII. Mbathjet	XIII. Artikuj prej guri, laqi, qeramike dhe xhami	XV. Metalet bazë dhe artikuj prej tyre	XVI. Makineritë, veglat, pajisjet elektrike, etj	XVII. Mjetet e transportit	XX. Artikuj tjerë të prodhuar	
2004	56.5	2.6	3.8	2.4	1.0	3.7	5.9	0.4	0.4	1.4	0.1	1.8	19.7	9.2	2.0	0.7
2005	56.3	2.9	4.6	3.2	1.2	1.0	6.1	0.4	0.4	0.6	0.1	0.4	24.8	6.5	2.3	0.4
2006	110.8	5.1	6.2	18.8	1.2	3.2	7.2	0.8	0.7	0.7	0.1	0.7	53.1	7.7	1.4	0.6
2007	165.1	9.1	8.4	27.3	0.9	6.5	6.5	1.7	1.0	1.2	0.1	1.2	74.1	21.3	1.5	2.8
2008	198.5	9.0	10.6	18.7	1.8	6.5	4.9	1.7	1.1	2.5	0.1	1.5	124.8	8.8	2.3	2.3
2009	165.3	9.5	9.4	25.0	1.5	6.4	4.5	0.9	1.0	5.2	0.1	1.2	88.4	7.2	1.6	1.9
2010	296.0	12.2	11.5	38.9	1.4	8.2	9.7	1.3	1.0	8.3	0.1	1.4	186.1	10.9	1.4	1.9
2011	319.2	12.8	12.9	40.6	2.3	12.4	9.4	1.6	1.4	11.7	0.1	1.2	193.1	15.3	1.1	2.1
2012	276.1	14.4	16.1	36.5	2.5	14.0	10.4	1.8	1.6	11.4	0.2	0.8	145.8	16.7	0.7	2.5
2013	293.8	15.4	19.3	48.4	1.7	18.2	11.7	2.1	1.8	12.8	0.7	1.2	143.9	12.6	0.5	2.6
2014	324.5	18.5	20.5	44.7	2.6	16.3	11.4	2.7	2.5	14.7	1.8	2.9	167.4	13.4	0.9	3.6
2015	325.3	15.5	25.4	41.6	2.9	23.5	10.8	2.5	2.8	12.0	3.0	2.5	157.7	12.3	1.8	4.6
2016	309.6	16.8	27.6	63.9	4.7	28.9	11.2	3.6	4.0	8.8	3.4	3.6	111.2	9.2	1.5	9.8
2017	378.0	21.6	33.5	70.5	11.1	32.2	15.1	4.6	5.2	9.6	3.5	5.9	126.3	17.8	2.5	10.3
2018	367.5	23.8	39.1	51.3	7.4	44.8	10.9	5.7	5.4	10.6	2.1	7.8	125.2	11.5	3.2	13.1
2019	383.5	23.0	39.8	40.0	8.2	50.8	6.5	5.8	4.4	11.5	2.5	8.5	134.4	16.9	4.0	20.0
2020	475.0	31.8	43.6	26.1	18.8	57.2	4.1	5.4	4.5	15.3	2.6	10.5	174.0	20.4	5.2	49.8
2021	756.0	31.9	57.7	45.0	17.6	80.4	7.8	10.2	7.6	26.0	4.1	19.2	244.2	30.7	7.3	156.8
2022	997.8	33.3	69.5	181.3	20.4	127.9	9.4	15.6	11.2	31.7	4.2	30.4	212.6	30.9	11.1	179.7
2023	874.5	34.8	92.8	60.8	28.7	116.5	6.5	16.4	12.8	45.8	6.8	31.8	180.2	43.8	20.6	134.9
2024	943.6	44.3	105.6	85.3	31.1	119.8	6.3	17.6	13.9	56.3	5.0	37.2	220.9	48.2	13.6	102.4
2024 Prill	73.2	1.9	8.0	3.9	2.7	10.8	0.6	1.2	1.0	6.4	0.6	3.0	18.2	4.1	1.1	7.6
Maj	85.7	2.8	9.2	7.6	2.9	11.2	0.6	2.0	1.6	6.4	0.4	3.1	20.6	4.2	1.8	8.7
Qershor	73.4	2.9	9.3	4.3	2.9	9.8	0.6	1.2	1.3	3.8	0.3	3.2	19.5	4.0	1.1	7.2
Korrik	86.1	4.4	10.1	13.2	2.8	9.5	0.6	1.5	1.3	4.4	0.3	3.2	20.0	3.7	1.0	7.6
Gusht	83.6	4.7	9.5	16.1	2.6	9.2	0.2	1.2	1.3	3.9	0.4	2.8	16.3	2.6	1.3	8.5
Shtator	77.5	5.0	8.6	5.0	3.0	10.0	0.4	1.7	1.2	5.2	0.5	3.0	18.0	4.3	1.1	7.8
Tetor	87.3	4.6	10.3	9.5	2.8	10.9	0.6	1.9	1.1	5.1	0.5	4.0	19.7	3.6	0.7	9.1
Nëntor	96.1	4.3	10.9	13.5	2.4	11.0	0.5	2.0	1.1	4.5	0.2	3.9	19.1	5.8	1.1	9.5
Dhjetor	69.6	3.3	10.4	5.1	1.9	8.0	0.5	1.4	1.0	5.2	0.1	2.4	14.1	3.2	1.1	7.2
2025 Janar	59.7	2.5	6.9	1.8	1.9	8.4	0.7	1.4	0.7	3.9	0.1	2.4	14.4	3.3	1.2	8.3
Shkurt	67.3	2.4	7.2	3.5	2.2	10.2	0.4	1.4	0.9	4.2	0.3	3.0	17.6	4.1	0.8	7.3
Mars	74.7	2.5	8.8	6.7	2.9	8.9	0.5	1.6	1.2	5.4	0.3	3.3	17.7	4.7	0.9	8.0
Prill	73.9	2.3	8.7	5.0	2.8	10.3	0.4	1.8	1.2	5.7	0.3	3.5	17.0	4.7	1.2	7.4
Maj	81.4	3.3	10.7	3.3	2.8	12.0	0.4	1.7	1.2	6.7	0.3	3.6	19.9	4.4	0.9	8.0
Qershor	80.4	4.3	10.5	5.4	2.8	10.1	0.5	1.8	1.1	3.9	0.3	3.3	17.2	4.5	0.9	7.9
Korrik	83.8	7.3	11.9	6.2	2.7	10.5	0.4	1.6	1.4	4.4	0.2	3.9	18.2	4.4	0.9	7.2
Gusht	76.2	5.7	10.5	10.5	2.1	8.3	0.3	1.2	1.0	4.4	0.2	2.7	13.7	5.0	0.7	7.7

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe llogaritjet e BQK-së.

Tabela 35.4 Tregtia në mallra - importet sipas grupit të mallrave

(Në milionë euro)

Përshkrimi	Gjithsej, prej të cilave:															
	I. Kafshët e gjalla dhe produktet blegtorale	II. Produkte perimesh	IV. Artikuj ushqimor të përgaditur, pije dhe duhan	V. Produkte minerale	VI. Produktet e industrisë kimike ose të industrive të ngjashme	VII. Plastika , goma dhe artikuj prej tyre	IX. Druri dhe artikuj prej tij	X. Material celulozë, letër dhe artikuj prej tyre	XI. Tekstilë dhe artikuj prej tyre	XII. Mbatshjet	XIII. Artikuj prej guri, llaçi, keramike dhe xhami	XV. Metalet bazë dhe artikuj prej tyre	XVI. Makinerit ë, veglat, pajisjet elektrike, etj.	XVII. Mjetet e transportit	XX. Artikuj tjerë të prodhuar	
2004	1,063.2	52.4	68.0	165.4	173.1	98.0	42.5	29.9	33.4	31.2	10.4	54.9	77.5	116.8	50.2	35.4
2005	1,157.5	54.0	57.2	163.3	207.3	91.1	51.0	30.5	23.5	35.9	11.3	51.5	90.3	129.2	104.2	28.9
2006	1,305.9	50.5	73.0	180.6	241.7	107.7	60.7	30.3	27.6	45.1	14.3	57.0	122.6	153.3	79.3	29.5
2007	1,576.2	61.2	83.4	222.2	295.3	119.9	72.8	35.4	31.9	53.0	16.3	63.0	144.3	203.4	95.9	37.9
2008	1,928.2	85.4	103.6	261.9	378.6	138.8	86.1	41.7	39.0	64.0	18.3	67.2	179.6	239.9	131.1	44.5
2009	1,935.5	84.6	90.0	241.6	331.3	142.9	95.7	44.9	45.4	69.1	18.8	73.5	159.4	278.7	162.2	50.9
2010	2,144.9	87.0	108.5	261.7	419.2	146.6	108.1	49.0	49.2	71.7	24.3	84.7	190.0	288.2	142.1	58.3
2011	2,479.3	97.4	136.8	303.9	538.1	177.8	137.5	53.8	58.5	88.4	27.5	91.2	228.0	267.6	155.3	61.9
2012	2,506.9	101.3	136.4	311.0	550.0	185.8	140.3	51.5	38.9	83.2	23.0	95.3	248.5	268.0	150.6	61.4
2013	2,449.1	105.8	124.3	327.9	481.3	190.3	148.1	52.8	38.8	87.6	24.0	96.8	247.2	256.8	135.5	70.3
2014	2,538.3	115.3	133.0	342.8	467.8	195.6	147.8	55.1	38.8	120.4	29.0	100.3	227.9	286.2	141.0	70.5
2015	2,634.7	112.0	143.4	352.7	404.2	213.8	163.2	62.4	38.7	122.6	30.6	106.7	260.5	310.4	164.1	78.9
2016	2789.5	109.9	147.9	373.1	327.5	221.5	188.3	72.6	41.7	136.7	35.0	111.2	275.4	357.7	220.0	91.0
2017	3,047.2	121.5	148.8	395.9	442.9	230.4	194.3	77.2	46.1	140.0	36.2	111.1	307.2	361.2	267.6	88.2
2018	3,347.0	132.0	151.8	400.6	510.6	235.2	214.0	73.5	47.7	162.5	39.1	118.1	372.2	435.1	268.8	105.6
2019	3,497.1	148.8	160.6	420.5	517.7	247.0	220.9	83.4	52.5	173.3	43.6	115.7	371.7	431.4	314.8	100.0
2020	3,296.9	147.2	163.9	422.3	353.8	283.9	224.6	80.6	47.2	163.2	35.1	112.5	351.2	435.0	289.0	87.6
2021	4684.2	198.6	175.0	556.0	629.6	355.8	338.8	105.3	63.8	235.9	44.7	162.8	520.3	596.7	451.2	126.4
2022	5639.0	280.0	201.8	653.2	1045.0	402.9	384.3	124.2	86.3	267.6	54.1	194.9	593.2	624.8	409.7	146.7
2023	5912.8	271.3	234.3	691.0	846.0	405.9	345.9	118.0	84.1	336.8	70.1	193.9	593.8	679.7	590.1	178.8
2024	6371.1	320.6	244.5	768.5	884.7	475.2	359.1	125.4	83.7	348.6	69.2	187.4	627.0	788.2	741.7	169.4
2924 Prill	503.9	26.4	22.4	55.8	68.6	41.2	32.9	10.5	6.2	27.2	6.4	15.8	48.0	58.3	57.8	13.9
Maj	516.3	26.5	20.9	59.1	68.9	37.5	31.1	11.4	6.3	28.5	4.5	17.7	52.6	63.6	62.4	12.6
Qershori	510.0	24.1	18.3	63.2	60.4	38.7	29.0	11.3	6.8	25.0	5.0	18.0	50.0	67.3	60.8	16.2
Korriku	593.2	29.0	17.7	80.6	70.0	41.0	33.7	12.9	7.8	30.2	6.3	17.9	52.2	85.2	71.8	17.6
Gusht	588.2	29.8	16.4	82.4	92.7	38.6	29.6	12.4	10.2	32.7	6.0	16.9	60.5	66.6	61.1	16.4
Shtatori	509.5	22.6	18.4	53.7	65.3	37.5	29.1	10.0	6.8	34.0	7.6	17.1	56.2	68.4	57.1	12.8
Tetori	580.3	26.6	21.3	63.6	81.7	43.8	35.4	10.8	6.1	36.1	7.5	17.0	55.0	69.5	76.8	13.8
Nëntori	566.9	29.0	24.0	65.5	70.6	41.5	31.5	10.5	7.4	28.9	5.3	15.9	63.0	80.1	64.6	14.1
Dhjetori	631.2	34.4	24.9	79.9	104.5	44.4	27.4	11.4	7.5	29.9	3.9	15.5	48.9	82.6	78.5	16.8
2025 Janar	473.9	24.6	20.8	48.2	96.8	32.2	21.7	7.8	5.3	26.6	4.7	11.5	40.3	45.5	66.6	11.3
Shkurt	518.7	26.7	24.1	58.7	87.1	40.6	28.7	9.2	6.7	27.6	5.7	14.3	50.1	54.9	58.4	12.7
Mars	610.6	30.1	29.8	65.2	96.8	46.2	33.0	10.1	7.7	36.8	8.1	18.1	54.8	78.1	62.6	16.5
Prill	566.2	25.8	25.0	62.8	72.3	41.6	31.9	10.9	7.2	31.5	5.8	18.7	51.4	72.9	71.3	16.6
Maj	604.7	31.8	25.0	74.3	59.7	47.5	34.1	13.1	7.0	30.4	4.8	20.8	66.6	78.4	76.2	17.8
Qershori	578.7	27.7	24.1	75.0	81.0	43.8	32.0	11.7	6.9	24.6	4.0	17.6	49.7	76.4	71.4	15.8
Korriku	660.2	33.1	21.7	85.8	86.6	53.6	33.4	14.0	8.5	32.9	6.6	21.4	58.4	79.0	86.6	18.9
Gusht	613.0	31.7	19.1	80.5	95.0	46.1	32.1	10.2	8.4	33.3	6.6	19.5	53.2	69.8	73.9	17.3

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe llogaritjet e BQK-së.

Tabela 36.1. Kursi devizor - kundrejt valutës euro

(Mesatarja mujore)

Përshkrimi	Leku Shqiptar (ALL)	Frangu Zviceran (CHF)	Paundi Britanik (GBP)	Kuna Kroate (HRK)	Denari Maqedon (MKD)	Dinari Serb (RSD)	Lira Turke (TRL)	Dollari Amerikan (USD)
2007 Dhjetor	121.01	1.66	0.72	7.31	60.92	79.24	1.72	1.46
2008 Dhjetor	123.07	1.54	0.90	7.19	61.40	88.60	2.08	1.34
2009 Dhjetor	137.17	1.50	0.90	7.29	61.18	96.02	2.20	1.46
2010 Dhjetor	138.85	1.28	0.85	7.39	61.50	106.25	2.02	1.32
2011 Dhjetor	138.16	1.23	0.84	7.51	60.87	104.64	2.46	1.32
2012 Dhjetor	139.72	1.21	0.81	7.53	61.51	113.54	2.34	1.31
2013 Dhjetor	140.21	1.22	0.84	7.64	61.53	114.71	2.83	1.37
2014 Dhjetor	140.11	1.20	0.79	7.67	61.70	121.53	2.83	1.23
2015 Dhjetor	137.65	1.08	0.73	7.64	61.62	121.75	3.18	1.09
2016 Dhjetor	135.28	1.08	0.84	7.54	61.49	123.79	3.69	1.05
2017 Dhjetor	133.25	1.17	0.88	7.54	61.68	119.14	4.55	1.18
2018 Dhjetor	123.45	1.13	0.90	7.40	61.49	118.28	6.06	1.14
2019 Dhjetor	122.17	1.09	0.85	7.44	61.55	117.54	6.50	1.11
2018 Dhjetor	124.39	1.13	0.89	7.43	61.50	118.41	6.14	1.14
2020 Dhjetor	123.55	1.08	0.91	7.54	61.69	117.58	9.38	1.22
2021 Dhjetor	120.81	1.04	0.85	7.52	61.67	117.58	15.40	1.13
2022 Dhjetor	114.93	0.99	0.87	7.54	61.63	117.31	19.76	1.06
2023 Dhjetor	102.78	0.94	0.86	—	61.49	117.17	31.72	1.09
2024 Mars	103.57	0.97	0.86	—	61.56	117.19	34.82	1.09
Prill	101.48	0.98	0.86	—	61.49	117.14	34.69	1.07
Maj	100.52	0.98	0.86	—	61.50	117.12	34.86	1.08
Qershor	100.35	0.96	0.85	—	61.55	117.07	35.07	1.08
Korrik	100.31	0.97	0.84	—	61.50	117.05	35.70	1.08
Gusht	99.97	0.95	0.85	—	61.49	117.04	37.11	1.10
Shtator	99.35	0.94	0.84	—	61.49	117.05	37.82	1.11
Tetor	98.68	0.94	0.84	—	61.49	117.03	37.35	1.09
Nëntor	98.21	0.94	0.83	—	61.49	116.99	36.63	1.06
Dhjetor	98.30	0.93	0.83	—	61.49	116.97	36.66	1.05
2025 Janar	98.51	0.94	0.83	—	61.54	117.12	36.80	1.03
Shkurt	99.03	0.94	0.83	—	61.51	117.13	37.69	1.04
Mars	99.22	0.95	0.84	—	61.66	117.17	40.17	1.08
Prill	99.07	0.93	0.85	—	61.57	117.20	42.77	1.12
Maj	98.21	0.94	0.84	—	61.65	117.22	43.79	1.13
Qershor	98.06	0.93	0.84	—	61.61	117.20	45.43	1.15
Korrik	97.72	0.93	0.86	—	61.66	117.17	46.98	1.16
Gusht	97.29	0.93	0.86	—	61.53	117.17	47.49	1.16

Tabela 36.2. Norma nominale dhe reale efektive e këmbimit

(Janar 2007=100)

Përshkrimi	Indeksi			
	NNEK	NREK	NREK (CEFTA)	NREK (BE)
2007	100.2	105.4	103.8	105.8
2008	102.2	105.1	106.1	103.9
2009	101.6	102.2	101.3	102.6
2010	100.8	104.8	105.8	106.4
2011	101.1	105.8	106.6	106.9
2012	101.2	106.6	106.9	108.6
2013	102.1	107.2	107.7	107.8
2014	101.9	106.0	107.4	107.3
2015	101.6	104.8	106.4	107.0
2016	102.2	105.1	107.1	105.8
2017	102.6	105.0	106.4	105.36
2018	102.9	104.7	106.8	104.7
2019	104.1	107.0	107.8	105.5
2020	105.7	108.0	107.8	105.5
2021 Dhjetor	107.0	112.5	112.4	106.8
2022 Dhjetor	107.7	117.9	119.8	108.5
2023 Dhjetor	109.1	118.3	116.6	107.7
2024 Mars	109.7	118.9	117.4	107.7
Prill	109.5	118.8	117.2	107.1
Maj	109.6	118.2	116.5	106.6
Qershor	109.5	118.4	117.3	106.3
Korrik	109.6	118.2	116.8	106.4
Gusht	109.7	118.5	117.0	106.5
Shtator	109.7	118.2	116.5	106.3
Tetor	109.5	118.4	117.3	106.1
Nëntor	109.4	118.3	116.9	106.5
Dhjetor	109.4	118.7	117.4	107.0
2025 Janar	109.4	119.9	118.2	108.7
Shkurt	109.5	119.7	118.2	107.7
Mars	110.0	121.4	120.3	108.0
Prill	110.4	121.4	119.6	107.7
Maj	110.4	121.7	119.8	108.0
Qershor	110.7	122.5	120.4	108.4
Korrik	110.7	122.6	120.4	108.5
Gusht	110.8	123.2	120.9	108.8

III. SHËNIME SQARUESE

Bazuar në *Ligjin Nr. 03/L-074, Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës*, e specifikuar edhe në *Rregulloren mbi Statistikat Monetare-Financiare dhe Llogaritë Financiare* si dhe *Rregulloren mbi Statistikat e Bilancit të Pagesave dhe të Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare*, BQK-ja përpilon dhe publikon statistika si dhe shpalosë informacione lidhur me metodikën statistikore. BQK-ja është po ashtu bartës (prodhues) i statistikave zyrtare bazuar në *Ligjin mbi Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës*. Statistikat të cilat hyjnë në kuadër të përgjegjësive të BQK-së janë statistikave monetare dhe financiare dhe statistikave të sektorit të jashtëm (statistikave të bilancit të pagesave, pozicionit ndërkombëtar të investimeve dhe statistikave të borxhit të jashtëm). Përveç kësaj, BQK-ja përpunon dhe publikon edhe statistika nga burime tjera siç janë statistikave të sektorit real dhe fiskal.

Bazuar në *Ligjin Nr. 03/L-074, Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës* është përgjegjëse për përgatitjen dhe publikimin e Statistikave Monetare dhe Financiare.

Statistikat për të cilat BQK është bartës zyrtar e që përfshihen në Buletinin Mujor Statistikor përpilohen dhe publikohen në bazë të standardeve statistikore ndërkombëtare të FMN-së, BQE-së, Eurostatit, ndër të cilat veçohen: *Manuali mbi Statistikat Monetare dhe Financiare* (FMN 2000), *Udhëzuesi mbi Statistikat Monetare dhe Financiare* (FMN 2008), *Manuali mbi Statistikat e Bilancit të Pagesave* (FMN 1993), *Udhëzuesi mbi Statistikat e Bilancit të Pagesave* (FMN 1995), *Manuali mbi Bilancin e Pagesave dhe Pozicionin e Investimeve Ndërkombëtare* (FMN 2009), *Manuali mbi Normat e Interesit të Institucioneve Monetare Financiare* (BQE 2003), *Sistemi i Llogarive Kombëtare* (SNA 2008), *Sistemi Evropian i Llogarive Kombëtare dhe Regjionale* (ESA 95), etj.

Metodika e detajuar lidhur me përpilimin e statistikave monetare-financiare dhe të bilancit të pagesave është e publikuar në faqen e internetit të BQK-së, në vegëzat në vazhdim:

[Metodika mbi Statistikat Monetare dhe Financiare;](#)

[Metodika mbi Statistikat e Bilancit të Pagesave.](#)

Shënime sqaruese paraqesin një përshkrim të shkurtër mbi metodikën, përmbajtjen, periodicitetin dhe burimin e grafikëve dhe tabelave të paraqitura në këtë publikim. Në kuadër të shënimeve sqaruese paraqiten edhe ndryshimet metodike dhe implikimet në zërat e caktuar që janë publikuar në këtë buletin.

PJESA I: GRAFIKËT

Grafik 1. Asetet e korporatave financiare

Përshkrimi: Korporatat financiare përbëjnë korporatat rezidente që janë të angazhuara në ndërmjetësimin financiar. Të dhënat e paraqitura përfshijnë BQK-në, korporatat tjera depozituese (bankat komerciale), korporatat tjera financiare (institucionet mikrofinanciare, kompanitë e sigurimeve, fondet pensionale, dhe ndihmësit financiar). Të dhënat e paraqitur janë të dhëna të agreguara.

Periodiciteti: Tremujor

Burimi i të dhënave: Tabela 3.1, 4.1, dhe 5.1

Grafiku 2. Asetet neto të korporatave financiare

Përshkrimi: Asetet e jashtme neto përbëhen nga kërkesat ndaj jorezidentëve minus obligimet ndaj jo rezidentëve. Ky zë llogaritet kur kërkesave ndaj jo rezidentëve i zbriten obligimet ndaj jo rezidentëve. Në këtë kontekst përfshihen asetet e jashtme neto të BQK-së, korporatave tjera depozituese (bankave komerciale), korporatat tjera financiare (institucionet mikrofinanciare, kompanitë e sigurimeve, fondet pensionale, dhe ndihmësit financiar).

Periodiciteti: Tremujor

Burimi i të dhënave: Tabela 3.1, 4.1, dhe 5.1

Grafik 3. Ecuria e asetëve të jashtme neto të korporatave financiare

Përshkrimi: Ecuria e asetëve të jashtme neto të korporatave financiare llogaritet bazuar në krahasimin vjetor në nivel të BQK-së, korporatave tjera depozituese (bankave komerciale), korporatave tjera financiare (institucioneve mikrofinanciare, kompanive të sigurimeve, fondeve pensionale, dhe ndihmësve financiar). Ecuria e asetëve të jashtme të korporatave tjera financiare është përlllogaritur bazuar në vlerën e asetëve në nivel të këtyre korporatave, në bazë të konsoliduar, dhe më pastaj duke e llogaritur normën vjetore të rritjes.

Periodiciteti: Tremujor

Burimi i të dhënave: Tabela 3.1, 4.1, dhe 5.1

Grafik 4. Depozitat në BQK sipas sektorëve

Përshkrimi: Ndarja sektoriale e depozitave e paraqitur në grafik është bazuar në standardet statistikore ndërkombëtare. Në Kosovë, korporatat tjera depozituese janë bankat komerciale, ndërsa korporatat tjera financiare përbëhen nga kompanitë e sigurimeve, fondet pensionale, institucionet mikrofinanciare, agjencitë për transferimin e parave dhe këmbimoret. Depozitat e Agjencisë Kosovare të Privatizimit janë paraqitur në kuadër të depozitave të qeverisë qendrore, sipas maturitetit.

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Tabela 10.2

Grafik 5. Depozitat në korporatat tjera depozituese sipas sektorëve dhe valutave

Përshkrimi: Korporatat tjera depozituese përbëhen nga korporatat dhe kuazi korporatat financiare rezidente (përveç bankës qendrore) që janë të angazhuara në ndërmjetësimin financiar dhe që obligimet e tyre janë pjesë e parasë së gjerë. Në Kosovë, korporatat tjera depozituese janë bankat komerciale. Depozitat e qeverisë përfshinë depozitat e qeverisë qendrore (p.sh. ministritë, etj) dhe lokale (p.sh. komunat). Korporatat tjera financiare përfshinë të gjitha institucionet financiare përveç bankës qendrore dhe korporatave tjera depozituese të cilat raportohen si të veçanta. Korporatat publike jofinanciare përfshijnë korporatat publike (p.sh. PTK-ja, KEK-u, etj), ndërsa korporatat tjera jofinanciare përfshijnë kompanitë private jofinanciare. Kategoria e ekonomive familjare përfshinë të gjitha ekonomitë familjare që kanë llogari bankare, ndërsa ajo e jorezidentëve përfshinë të gjithë jo rezidentët që kanë llogari bankare në Kosovë. Pjesëmarrja e depozitave në valutën në gjithsej depozitat është bërë duke pjesëtuar depozitat në valutën euro me gjithsej depozitat. Për më shumë rreth ndarjes sektoriale dhe kriterit të rezidencës, konsultoni [Metodika mbi Statistikat Monetare dhe Financiare](#).

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Tabela 12.1 dhe 12.5

Grafik 6. Depozitat në korporatat tjera depozituese sipas maturiteteve

Përshkrimi: Korporatat tjera depozituese përbëhen nga korporatat dhe kuazi korporatat financiare rezidente (përveç bankës qendrore) që janë të angazhuara në ndërmjetësimin financiar dhe që obligimet e tyre janë pjesë e parasë së gjerë. Në Kosovë, korporatat tjera depozituese janë bankat komerciale. Klasifikimi i depozitave në maturitete është bërë bazuar në kriterin maturimit origjinal (p.sh. nëse në maj 2012 kemi depozitim për një afat maturimit një vjeçar, atëherë ky afatizim do të raportohet në kuadër të zërit “Deri në një vit” deri në momentin kur të kryhet afatizimi). Që nga fillimi i vitit 2010, ekziston një ndarje e re e depozitave dhe atë: depozitat e transferueshme, depozitat tjera (të afatizuara) dhe depozitat e kursimit. Deri në fund të vitit 2009, depozitat e kursimit kanë qenë të përfshira në kuadër të depozitave të afatizuara.

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Tabela 12.1 deri 12.5

Grafik 7. Kreditë e korporatave tjera depozituese sipas sektorëve

Përshkrimi: Korporatat tjera depozituese përbëhen nga korporatat dhe kuazi korporatat financiare rezidente (përveç Bankës Qendrore) që janë të angazhuara në ndërmjetësimin financiar dhe që obligimet e tyre janë pjesë e parasë së gjerë. Në Kosovë, korporatat tjera depozituese janë bankat komerciale. Ndarja sektoriale e kredive është bazuar në sektorin që i është dhënë kredia. Nëse kredia i është dhënë kompanisë atëherë ajo kredi klasifikohet si kredi ndaj korporatave jofinanciare (publike ose private).

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Tabela 13.1

Grafik 8. Kreditë e reja të korporatave tjera depozituese sipas sektorëve

Përshkrimi: Korporatat tjera depozituese përbëhen nga korporatat dhe kuazi korporatat financiare rezidente (përveç bankës qendrore) që janë të angazhuara në ndërmjetësimin financiar dhe që obligimet e tyre janë pjesë e parasë së gjerë. Në Kosovë, korporatat tjera depozituese janë bankat komerciale. Kreditë e reja përfshijnë kreditë e dhëna vetëm brenda një periudhe referuese dhe si të tilla janë të dhëna jokumulative (p.sh. kreditë për muajin maj 2012 paraqesin kreditë e dhëna vetëm gjatë atij muaji, duke mos përfshirë kreditë e dhëna gjatë periudhave paraprake, siç është rasti tek kreditë kumulative).

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Tabela 13.2

Grafik 9. Kreditë e korporatave tjera depozituese sipas sektorëve ekonomik

Përshkrimi: Korporatat tjera depozituese përbëhen nga korporatat dhe kuazi korporatat financiare rezidente (përveç bankës qendrore) që janë të angazhuara në ndërmjetësimin financiar dhe që obligimet e tyre janë pjesë e parasë së gjerë. Në Kosovë, korporatat tjera depozituese janë bankat komerciale. Ndarja e kredive sipas sektorëve ekonomik është bazuar në klasifikimin NACE, që është ndarje e kredive sipas qëllimit.³

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Tabela 13.3

Grafik 10. Kreditë e korporatave tjera depozituese sipas maturiteteve

Përshkrimi: Korporatat tjera depozituese përbëhen nga korporatat dhe kuazi korporatat financiare rezidente (përveç bankës qendrore) që janë të angazhuara në ndërmjetësimin financiar dhe që obligimet e tyre janë pjesë e parasë së gjerë. Në Kosovë, korporatat tjera depozituese janë bankat komerciale. Ky klasifikim i kredive sipas maturiteteve është bazuar në kriterin origjinal (p.sh. nëse në maj 2012 janë dhënë kredi për një afat maturimi një vjeçar, atëherë këto kredi do të raportohen në kuadër të zërit “Deri në një vit” deri në momentin sa të kryhet afatizimi). Duke filluar që nga viti 2010 ekziston një ndarje më e detajuar e depozitave sipas afatit. Depozitat me maturitet “Mbi dy vite dhe deri në pesë vite” më herët kanë qenë të përfshira në kuadër të maturitetit “Mbi dy vite”.

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Tabela 13.1

Grafik 11. Raporti kredi-depozita dhe ndryshimi i tyre vjetor te KTD-të

Përshkrimi: Korporatat tjera depozituese përbëhen nga korporatat dhe kuazi korporatat financiare rezidente (përveç bankës qendrore) që janë të angazhuara në ndërmjetësimin financiar dhe që obligimet e tyre janë pjesë e parasë së gjerë. Në Kosovë, korporatat tjera depozituese janë bankat komerciale. Ecuria e kredive dhe depozitave është bërë në bazë vjetore përmes formulës së rritjes/zvogëlimit vjetor. Raporti i kredive në depozita përfshinë të gjitha kreditë pjesëtuar me depozitat, duke përjashtuar depozitat dhe kreditë ndërbankare.

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Tabela 11.1 dhe 11.2

³ Për më shumë rreth klasifikimit NACE shih http://epp.eurostat.ec.europa.eu/cache/ITY_OFFPUB/KS-RA-07-015/EN/KS-RA-07-015-EN.PDF

Grafik 12. Normat e interesit në depozita dhe kredi të korporatave tjera depozituese

Përshkrimi: Korporatat tjera depozituese përbëhen nga korporatat dhe kuazi korporatat financiare rezidente (përveç bankës qendrore) që janë të angazhuara në ndërmjetësimin financiar dhe që obligimet e tyre janë pjesë e parasë së gjerë. Në Kosovë, korporatat tjera depozituese janë bankat komerciale. Normat e interesit në depozita dhe kredi llogariten duke përdoruar formulën e normës efektive të interesit bazuar në mesataren e ponderuar aritmetike. Formula e llogaritjes së normës efektive është me sa vijon:

$$AAR = \left(1 + \frac{AG}{n}\right)^n - 1$$

ku AAR është norma e kontraktuar e vjetorizuar, AG paraqet normën nominale të kontraktuar në mes të palëve, dhe n është numri i periudhave të kapitalizimit brenda vitit. Atëherë, $n = 1$ nëse interesi paguhet një herë në vit (12/12), $n = 2$ kur interesi paguhet çdo gjashtë muaj (12/6), $n = 4$ kur interesi paguhet çdo tre muaj (12/3), dhe $n = 12$ kur interesi paguhet çdo muaj (12/1).

Këto të dhëna janë jokumulative që përfshijnë vetëm kontratat e reja gjatë muajit përkatës. Për më shumë rreth llogaritjes së normës së interesit konsultoni Metodikën mbi Statistikat Monetare dhe Financiare.

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Tabela 14.1 dhe 14.2

Grafik 13. Të hyrat dhe shpenzimet e korporatave tjera depozituese

Përshkrimi: Korporatat tjera depozituese përbëhen nga korporatat dhe kuazi korporatat financiare rezidente (përveç bankës qendrore) që janë të angazhuara në ndërmjetësimin financiar dhe që obligimet e tyre janë pjesë e parasë së gjerë. Në Kosovë, korporatat tjera depozituese janë bankat komerciale. Në kuadër të të hyrave përfshihen të gjitha të hyrat nga aktiviteti bankar, si të hyrat nga interesi, të hyrat jo nga interesi, etj. ndërsa në kuadër të shpenzimeve përfshihen shpenzimet nga interesi, shpenzimet tjera jo nga interesi, shpenzimet administrative (përfshirë edhe shpenzimet e stafit të bankave) dhe të ngjashme. Të dhënat janë të agreguara në nivel të korporatave tjera depozituese. Të dhënat janë kumulative brenda vitit kalendarik (p.sh. të dhënat për janar 2012 përfshijnë të dhënat vetëm për janar 2012, ndërsa të dhënat për maj 2012 përfshijnë të dhënat që nga janari 2012 deri në maj 2012).

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Tabela 15.1

Grafik 14. Ecuria e të hyrave në korporatat tjera depozituese dhe kontribuesit

Përshkrimi: Korporatat tjera depozituese përbëhen nga korporatat dhe kuazi korporatat financiare rezidente (përveç bankës qendrore) që janë të angazhuara në ndërmjetësimin financiar dhe që obligimet e tyre janë pjesë e parasë së gjerë. Në Kosovë, korporatat tjera depozituese janë bankat komerciale. Rritja e të hyrave llogaritet duke përdorur të dhënat kumulative brenda vitit kalendarik, përmes formulës së rritjes. Në mënyrë që të identifikohet ndikimi i secilit komponent, është përdorur formula e kontributit (pikë përqindja):

$$\text{Pikë përqindja} = \frac{(g_0 - g_{-1})}{z_{-1}} * 100$$

ku variabla g është pjesë e variablës z .

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Tabela 15.1

Grafik 15. Ecuria e shpenzimeve në korporatat tjera depozituese dhe kontribuesit

Përshkrimi: Korporatat tjera depozituese përbëhen nga korporatat dhe kuazi korporatat financiare rezidente (përveç bankës qendrore) që janë të angazhuara në ndërmjetësimin financiar dhe që obligimet e tyre janë pjesë e parasë së gjerë. Në Kosovë, korporatat tjera depozituese janë bankat komerciale. Rritja e shpenzimeve llogaritet duke përdorur të dhënat kumulative brenda vitit kalendarik, përmes formulës së rritjes. Në mënyrë që të identifikohet ndikimi i secilit komponent, është përdorur formula e kontributit (pikë përqindja):

$$\text{Pikë përqindja} = \frac{(g_0 - g_{-1})}{z_{-1}} * 100$$

ku variabla g është pjesë e variablës z .

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Tabela 15.1

Grafik 16. Normat e interesit në kredi të ndërmjetësve tjerë financiar

Përshkrimi: Ndërmjetësit tjerë financiar përbëhen nga të gjitha korporatat rezidente të angazhuara në ndërmjetësimin financiar përveç korporatave depozituese, kompanive të sigurimit, fondeve pensionale, agjencive për transferimin e parave dhe këmbimoreve. Në Kosovë, ndërmjetësit tjerë financiar përbëhen nga institucionet mikrofinanciare. Ndërmjetësit tjerë financiar përfshijnë institucionet mikrofinanciare të cilat së bashku me korporatat tjera depozituese (bankat komerciale) janë institucionet e vetme në kuadër të sistemit financiar të Kosovës të licencuara për dhënien e kredive.

Normat e interesit llogariten dhe publikohen duke përdorur normën efektive vjetore. Sektorët janë ndarë korporatat jofinanciare dhe në ekonominë familjare, konsistente me standardet ndërkombëtare. Formula e llogaritjes së normës efektive është me sa vijon:

$$\text{Eff} = \frac{\left(1 + \frac{AG}{n}\right)^n - 1}{fee}; \quad \text{fee} = 1 - \text{disagio}$$

ku Eff është norma e kontraktuar e vjetorizuar, AG paraqet normën nominale të kontraktuar në mes të palëve, dhe n është numri i periudhave të kapitalizimit brenda vitit. Atëherë, $n = 1$ nëse interesi paguhet një herë në vit (12/12), $n = 2$ kur interesi paguhet çdo gjashtë muaj (12/6), $n = 4$ kur interesi paguhet çdo tre muaj (12/3), dhe $n = 12$ kur interesi paguhet çdo muaj (12/1). Raportimi i normave të kamatës në BQK nuk do të përfshijë asnjë taksë, tatim as ndonjë shpenzim tjetër të ndërlidhur me palët e treta, si taksat për shtetin, të cilat banka i paguan për klientin. Megjithatë, kosto (*shpenzimet administrative: fee*) e manifestuar si një zbritje (*disagio*) në rastin e një kredie duhet të konsiderohet si një pagesë e kamatës. *Disagio*, e përcaktuar si diferencë midis shumës nominale të kredisë dhe shumës së marrë nga klienti, do të konsiderohet si pagesa e kamatës në fillim të kontratës (*koha t_0*) dhe do të reflektohet në normën vjetore të dakorduar. *Disagio* është e lidhur direkt me procesimin e kredisë dhe kjo është një kosto interesi për marrëveshje specifike të kredisë ose kontratë të re. Këto të dhëna janë jokumulative që përfshijnë kontratat e reja gjatë muajit përkatës.

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Tabela 18.1

Grafik 17. Kreditë e reja të ndërmjetësve tjerë financiar sipas sektorëve

Përshkrimi: Ndërmjetësit tjerë financiar përbëhen nga të gjitha korporatat rezidente të angazhuara në ndërmjetësimin financiar përveç korporatave depozituese, kompanive të sigurimit, fondeve pensionale, agjencive për transferimin e parave dhe këmbimoreve. Në Kosovë, ndërmjetësit tjerë financiar përbëhen nga institucionet mikrofinanciare që janë të angazhuara në dhënien e kredive në Kosovë. Kreditë e korporatave tjera mikrofinanciare janë paraqitur si kredi të reja të dhëna gjatë muajit.

Kreditë e reja përfshijnë kreditë e dhëna vetëm brenda një periudhe referuese dhe si të tilla janë të dhëna jo kumulative (p.sh. kreditë për muajin maj 2012 paraqesin vetëm kreditë e dhëna gjatë atij muaji, duke mos përfshirë kreditë e dhëna gjatë periudhave paraprake, siç është rasti tek kreditë kumulative).

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Tabela 17.3

Grafik 18. Kreditë e ndërmjetësve tjerë financiar sipas maturiteteve

Përshkrimi: Ndërmjetësit tjerë financiar përbëhen nga të gjitha korporatat rezidente të angazhuara në ndërmjetësimin financiar përveç korporatave depozituese, kompanive të sigurimit, fondeve pensionale, agjencive për transferimin e parave dhe këmbimoreve. Në Kosovë, ndërmjetësit tjerë financiar përbëhen nga institucionet mikrofinanciare që janë të angazhuara në dhënien e kredive në Kosovë. Kreditë e korporatave tjera mikrofinanciare janë paraqitur në sistemin kumulativ. Kjo do të thotë vlerat e paraqitura paraqesin kreditë aktive, respektivisht kërkesat aktuale të institucioneve mikrofinanciare ndaj sektorëve përkatës, institucional dhe ekonomik. Kategorizimi në vargje kohore është bazuar në standardet statistikore ndërkombëtare.

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Tabela 17.1

Grafik 19. Kreditë e ndërmjetësve tjerë financiar sipas sektorëve

Përshkrimi: Ndërmjetësit tjerë financiar përbëhen nga të gjitha korporatat rezidente të angazhuara në ndërmjetësimin financiar përveç korporatave depozituese, kompanive të sigurimit, fondeve pensionale, agjencive për transferimin e parave dhe këmbimoreve. Në Kosovë, ndërmjetësit tjerë financiar përbëhen nga institucionet mikrofinanciare që janë të angazhuara në dhënien e kredive në Kosovë. Kreditë e korporatave tjera mikrofinanciare janë paraqitur në sistemin kumulativ. Kjo do të thotë vlerat e paraqitura paraqesin kreditë aktive, respektivisht kërkesat aktuale të institucioneve mikrofinanciare

ndaj sektorëve institucional. Klasifikimi është bërë duke u bazuar në sektorin që i është dhënë kredia, përderisa sektorimi është bazuar në standardet statistikore ndërkombëtare të FMN-së, etj.

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Tabela 17.1

Grafik 20. Kreditë e ndërmjetësve tjerë financiar sipas sektorëve ekonomik

Përshkrimi: Ndërmjetësit tjerë financiar përbëhen nga të gjitha korporatat rezidente të angazhuara në ndërmjetësimin financiar përveç korporatave depozituese, kompanive të sigurimit, fondëve pensionale, agjencive për transferimin e parave dhe këmbimoreve. Në Kosovë, ndërmjetësit tjerë financiar përbëhen nga institucionet mikrofinanciare që janë të angazhuara në dhënien e kredive në Kosovë. Kreditë e korporatave tjera mikrofinanciare janë paraqitur në sistemin kumulativ. Kjo do të thotë vlerat e paraqitura paraqesin kreditë aktive, respektivisht kërkesat aktuale të institucioneve mikrofinanciare ndaj sektorëve ekonomik. Klasifikimi i kredive sipas sektorëve ekonomik është bazuar në klasifikimin NACE, që është ndarje e kredive sipas qëllimit.⁴

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Tabela 17.2

Grafik 21. Buxheti i Kosovës

Përshkrimi: Qeveria e përgjithshme paraqet institucionin me fuqi legjislativ, juridike dhe ekzekutive në territorin e një shteti dhe përbëhet nga qeveria qendrore, qeveria federale, qeveria lokale dhe fondet e sigurimit social. Në rastin e Kosovës, ekzistojnë dy nivele, dhe atë qeveria e përgjithshme dhe qeveria lokale. Në kuadër të buxhetit të Kosovës prezantohen të hyrat dhe shpenzimet buxhetore. Të dhënat e prezantuara janë të dhëna jokumulative. BQK nuk është bartës zyrtar për statistikën e sektorit fiskal.

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Tabela 26.1 dhe 26.2

⁴ Për më shumë rreth klasifikimit NACE shih http://epp.eurostat.ec.europa.eu/cache/ITY_OFFPUB/KS-RA-07-015/EN/KS-RA-07-015-EN.PDF

Grafik 22. Çmimet

Përshkrimi: Statistikat mbi çmimet janë paraqitur bazuar në ndryshimin vjetor të çmimeve. Ndryshimi vjetor është bazuar në formulën e rritjes/zvogëlimit vjetor, duke përdorur indeksin kryesor të çmimeve. BQK nuk është bartës zyrtar i statistikave mbi çmimet. Formula për llogaritjen e ndryshimit vjetor të çmimeve është me sa vijon:

$$\text{Ndryshimi vjetor} = \left[\left(\frac{CPI^{Y,m}}{CPI^{Y-1,m}} \right) - 1 \right] * 100$$

ku $CPI^{Y,m}$ paraqet indeksin e çmimeve për muajin aktual të vitit aktual, ndërsa $CPI^{Y-1,m}$ paraqet indeksin e çmimeve për muajin aktual të vitit paraprak.

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Tabela 28.1

Grafik 23. Kategoritë kryesore të çmimeve

Përshkrimi: Kategoritë kryesore të çmimeve kanë të bëjnë me strukturën e indeksit të çmimeve. Përqindjet e llogaritura janë bërë bazuar në ndryshimin vjetor. Ndarja në kategoritë si ushqimi dhe pijet jo alkoolike, pijet alkoolike, etj bazohet në sistemin COICOP (Klasifikimi i konsumit individual sipas qëllimit).⁵

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Tabela 28.1

Grafik 24. Çmimet e importit dhe çmimet e prodhimit

Përshkrimi: Kuadër të çmimeve të importit përfshihen çmimet e artikujve konsumues të cilët importohen duke përdorur peshat specifike. Ndërsa tek çmimet e prodhimit përfshihen çmimet e prodhimeve vendore po ashtu duke përdorur peshat specifike.

Periodiciteti: Tremujor

Burimi i të dhënave: Tabela 28.2

Grafik 25. Kursi devizor kundrejt valutës euro

Përshkrimi: Kursi devizor përpilohet bazuar në mesataren mujore të kursit të valutave si leku shqiptar, frangu zviceran, funta britanike (Pound sterling), kuna kroate, denari maqedon, dinari serb, lira turke dhe dollari amerikan.

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Tabela 35.1

⁵ Për më shumë rreth klasifikimit COICOP shih <http://unstats.un.org/unsd/cr/registry/REGCST.asp?CI=5>

Grafik 26. Norma reale efektive e këmbimit

Përshkrimi: Norma Reale Efektive të Këmbimit (NREK) llogaritet duke përdorur Indeksine e Çmimeve të Konsumit (IÇK) dhe Indeksine e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK). Para se të llogaritet NREK, që më parë duhet të llogarisim Normën Nominale Efektive e Këmbimit (NNEK). Formula lidhur me llogaritjen e NNEK-ut është me sa vijon:

$$NNEK_t = 100 \sum_{i=1}^n \frac{E_{it}}{E_{i0}} w_i$$

ku i paraqet valutat individuale të vendeve, E_{it} paraqet normën nominale të këmbimit të valutës euro në raport me valutat e vendeve në baza mujore (t) e definuar si numri i njësi të valutës së vendit (i) për një njësi të valutës vendore, E_{i0} paraqet normën nominale të këmbimit të valutës euro në raport me valutat e vendit përkatës në periudhën bazë, dhe w_i është pesha për valutën e vendit (i).

NREK-u është llogaritur bazuar në formulën me sa vijon:

$$NREK_t = \sum_{i=1}^n \frac{w_i P_{dt}}{P_{ft}} NNEK_t$$

ku P_{ft} paraqet indeksin për çmimet e huaja në baza mujore (t) për secilin vend veç e veç duke krahasuar me periudhën bazë, përderisa P_{dt} paraqet IÇK-në e Kosovës në baza mujore (t) krahasuar me periudhën bazë.

Periodiciteti: Tremujor

Burimi i të dhënave: 35.2

Grafik 27. Bilanci tregtar

Përshkrimi: Në kuadër të bilancit tregtar përfshihen importi dhe eksporti i rregullt me të gjitha shtetet. Bilancin tregtar e llogarisim kur eksporteve ia zbrisim importet e mallrave. Të dhënat mbi importin dhe eksportin publikohen në sistemin kumulativ brenda vitit kalendarik (p.sh. të dhënat për janar 2012 përfshijnë të dhënat vetëm për janar 2012, ndërsa të dhënat për maj 2012 përfshijnë të dhënat që nga janari 2012 deri në maj 2012).

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Tabela 34.1 dhe 34.5

Grafik 28. Eksporti i mallrave

Përshkrimi: Në kuadër të eksporteve ndaj BE-së përfshihen të gjitha vendet e Bashkësisë Evropiane. Në kuadër të vendeve të CEFTA-s përfshihen Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia, dhe Shqipëria. Kategoria e vendeve tjera evropiane përfshihet shtetet si Zvicra, Rusia, Ukraina, Turqia, etj. Ndërsa në kategorinë e shteteve jo evropiane përfshihen të gjitha shtetet që nuk janë në kontinentin evropian si SHBA, Kina, Japoni, India, Egjipti, etj.

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Tabela 34.1

Grafik 29. Importi i mallrave

Përshkrimi: Në kuadër të importeve ndaj BE-së përfshihen të gjitha vendet e Bashkësisë Evropiane. Në kuadër të vendeve të CEFTA-s përfshihen Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia, dhe Shqipëria. Kategoria e vendeve tjera evropiane përfshihet shtetet si Zvicra, Rusia, Ukraina, Turqia, etj. Ndërsa në kategorinë e shteteve jo evropiane përfshihen të gjitha shtetet që nuk janë në kontinentin evropian si SHBA, Kina, Japoni, India, Egjipti, etj.

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Tabela 34.5

Grafik 30. Bilanci i Pagesave të Kosovës

Përshkrimi: Bilanci i pagesave paraqet informacion kyç ekonomik që përmbledhë në mënyrë sistematike transaksionet ekonomike të rezidentëve të Kosovës me botën e jashtme (jorezidentët), për një periudhë të caktuar kohore. Në grafik janë paraqitur kategoritë kryesore të bilancit të pagesave që janë: llogaria rrjedhëse, llogaria kapitale, llogaria financiare dhe, gabimet dhe harresat. Deri në vitin 2008 të dhënat paraqiten në baza vjetore, ndërsa që nga viti 2009 në baza tremujore dhe janë të dhëna jokomulative. Të dhënat janë paraqitur duke aplikuar parimin neto.

Periodiciteti: Tremujor

Burimi i të dhënave: Tabela 29.1

Grafik 31. Llogaria rrjedhëse

Përshkrimi: Llogaria rrjedhëse është njëra ndër kategoritë kryesore të bilancit të pagesave të Kosovës. Llogaria rrjedhëse paraqet ndryshimin neto në mes të eksporteve të mallrave, shërbimeve, të ardhurave dalëse dhe të transfereve dalëse në njërin anë, krahasuar me importet e mallrave, shërbimeve, të ardhurave hyrëse dhe transfereve hyrëse, në anën tjetër. Në kalkulimet e llogarisë rrjedhëse nuk përfshihen transaksionet financiare. Në grafik paraqitet ndikimi i kategorisë së mallrave, shërbimeve, të ardhurave dhe transfereve në llogarinë rrjedhëse të Kosovës. Deri në vitin 2008 të dhënat paraqiten në baza vjetore, ndërsa që nga viti 2009 në baza tremujore dhe janë të dhëna jokomulative. Të dhënat janë paraqitur duke aplikuar parimin neto.

Periodiciteti: Tremujor

Burimi i të dhënave: Tabela 29.2

Grafik 32. Llogaria financiare

